

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Seaside Investment Group” shpk**

Sot, në datë 19.07.2021, unë themeluesi, Bersi Xhelili, atësia Vesaf, shtetas Shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal I30309063Q, i datëlindjes 09.03.1983, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “Seaside Investment Group” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2
Objekti**


- 4) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :
 - a) Investimi në fushën e pasurive të paluajtshme; blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme, investimi dhe zhvillimi në pasuri të paluajtshme brenda dhe jashtë vendit, për qëllime banimi dhe industriale.
 - b) Dhënien me qira të pasurive të paluajtshme dhe çdo lloj investimi dhe zhvillimi të pasurive të marra me qira; dhënia me qira e ambienteve për banim, për biznes, zhvillimi i pasurive të marra me qira, bashkë investimi me kompani apo subjekte të tjera, financimi dhe shërbime të tjera të ngjashme.
 - c) Furnizimi i shërbimeve të ngjashme të karakterit ndërtimor me qëllim investimin fillestar, riparimin, mirëmbajtjen, modifikimin dhe shërbime të tjera.
 - d) Importin dhe eksportin e materialeve të ndryshme, pjesë e aktivitetit kryesor; import dhe eksport të materialeve ndërtimore, makineri dhe pajisje, inventar dhe materiale të tjera, në funksion të aktivitetit të shoqërisë.
- 5) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga “Myslym Shyri”, Ndërtesa Nr. 71, Hyrja 31, Apartamenti 1, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.



Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 120,000 (Një qind njëzet mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortaku Bersi Xhelili.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta).

Neni 6
Administratori

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet Bersi Xhelili, atësia Vesaf, shtetas Shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal I30309063Q, i datëlindjes 09.03.1983, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

Neni 7
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAK I VETËM
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Seaside Investment Group" shpk

BERSI XHELILI
Bersi Xhelili
(Emër, Mbiemër, Firma)

